



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1102/3 Prot.

Tiranë, më 02.11.2023

**V E N D I M**

**Nr. 222, Datë 02.11.2023**

Mbështetur në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi ankesën nr. 218, datë 17.10.2023, të paraqitur nga Gj.N kundër Bashkisë Lezhë dhe S.K, Prokuror, pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi në mes të tjerash informon se: “*Me datë 14.12.2020 unë së bashku me Avokate Sh.M, kemi paraqitur kallëzimin penal ndaj shtetasit:*

- *R.Ç, me detyre Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Lezhë.*
- *L.P, me detyre Shefi i Policisë, Bashkia Lezhë.*

*Si persona të dyshuar në kryerjen e veprave penale të:*

1. “*Kryerje e veprimeve arbitrare*” të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal.
2. “*Shpërdorimi i detyrës*” i parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
3. *Kallëzim Penal për kryerjen e veprës penale të “Pengim dhe ushtrim dhune ndaj avokatëve Sh.M dhe Gj.N, për të ushtruar detyrën në procesin gjyqësor” të parashikuar nga neni 316 i Kodit Penal.*

*Në lidhje me kallëzimin që kemi bërë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për ngjarjen dhe me Vendimin datë 13.01.2021, protokolluar me shkresën*

*nr. 11932, datë 01.04.2021 nga Prokurori i çështjes S.K, kemi marrë njoftim për mos fillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. 1477 të vitit 2020. Me cilësinë e të dëmtuarve nga vepra penale gjatë ushtrimit të detyrës së Avokatit dhe me cilësinë e kallëzuesve, duke mos qenë dakord me Vendimin e Prokurorisë, jemi drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, kundër vendimit të prokurorisë për mos fillimin e procedimit penal.*

*Pas shqyrtimit Gjyqësor, me Vendimin nr. 66, datë 28.05.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur:*

- 1. Shfuqizimin e Vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë datë 03.01.2021 “Për mos fillimin e procedimit penal” që i përket kallëzimit penal nr. 1477 të vitit 2020.*
- 2. Urdhërohet Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë të Regjistrojë procedimin penal, për veprën penale të “Shpërdorimi i Detyrës” e parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal, si dhe të kryejë hetimet e nevojshme në drejtimit e përcaktuara në pjesën arsyetuese të vendimit.*
- 3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër, brenda 10 ditëve nga e nesërmja e shpalljes, ndërsa për Prokurorinë nga e nesërmja e marrjes dijani.*

*Kundër Vendimit të Gjykatës me nr. 66, datë 28.05.2021, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, është bërë Ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër nga ana e një prokurori tjetër dhe konkretisht të prokurorit F.G sipas shkresës nr. 6677, datë 19.07.2021 të drejtuesit të Prokurorisë Lezhë.*

*Me Vendimin nr. 208, datë 22.09.2021, Gjykata e Apelit Shkodër ka Vendosur: Lënien në fuqi të Vendimit nr. 66, datë 28.05.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.*

*Në lidhje me kallëzimin penal në ngarkim të kallëzuarit L.P, nga ana e Prokurorit të çështjes nuk janë zbatuar vendimet e Gjykatës Lezhë e të Gjykatës së Apelit Shkodër, të cilët kanë vendosur shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë Lezhë, datë 13.01.2021 “Për mos fillimin e Procedimit Penal” që i përket kallëzimit penal nr. 1477 të vitit 2020, duke urdhëruar Prokurorinë Lezhë të Regjistrojë procedimin penal, për veprën penale të “Shpërdorimi i Detyrës” i parashikuar nga Neni 248 të Kodit Penal, si dhe të kryejë hetimet e nevojshme në drejtimit e përcaktuara në pjesën arsyetuese të vendimit.*

*Sa më sipër, nga ana e Prokurorit S.K i cili ushtron detyrën e prokurorit të çështjes, nuk janë zbatuar kërkesat ligjore të cilat bien në kundërshtim me Vendimet e gjykatës, duke zvarritur çështjen për tre vite me qëllime të caktuara për të favorizuar autorin e veprës penale në dëm të interesave të ligjshme të avokatëve që ishin dhunuar dhe keqtrajtuar në kryerje të detyrës brenda ambienteve të punës, në rastin konkret në zyrën e punës së tyre”.*

*Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil të prokurorit S.K.*

## II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

*Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:*

Së pari, lidhur me pretendimet e ankuesit kundër Bashkisë Lezhë, referuar informacionit të cituar në ankesë dhe materialeve bashkëngjitur saj, rezulton se periudha e ndodhjes së diskriminimit të pretenduar është përpara datës 14.12.2020, fakt i cili është pohuar nga vetë ankuesi gjatë parashtrimit të fakteve, kur ka deklaruar se në datë 14.12.2020 ka paraqitur kallëzim penal ndaj z. R.Ç me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Lezhë dhe z. L.P me detyrë Shefi i Policisë i Bashkisë Lezhë.

Në nenin 33, pika 4, gërma dh), të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet se: “Ankesa nuk pranohet kur: .... (2) paraqitet më vonë se tre vjet nga

ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese”. Parashikimi i sipërcituar nuk është kumulativ dhe kërkon si kriter për mospranimin e ankesës, plotësimin e njërit prej kushteve të mësipërme.

Për sa më sipër, KMD gjykon se momenti i ndodhjes së diskriminimit të pretenduar është data 14.12.2020, kur ankuesi ka depozituar kallëzimin penal ndaj zyrtarëve të Bashkisë Lezhë. Edhe momenti i marrjes dijani nga ankuesi mbi sjelljen diskriminuese të pretenduar nga ana e zyrtarëve të Bashkisë Lezhë është data 14.12.2020. Ndërkohë që, data e depozitimit të ankesës pranë KMD-së është 17.10.2023. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se momenti, i marrjes dijani mbi diskriminimin e pretenduar, daton më vonë se 2 (dy) vjet nga data e depozitimit të ankesës nr. 218, datë 17.10.2023 pranë KMD-së.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>.

Së dyti, lidhur me kërkimin e ankuesit për evidentimin e shkeljeve ligjore të kryera nga Prokurori S.K në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, kundrejt tij, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet, bazuar në arsyetimin vijues:

Pretendimet e ankuesit mund të zgjidhen vetëm nëpërmjet kontrollit gjyqësor, ankimimit përpara gjykatave të shkallëve më të larta.

Në nenin 194/1 të ligjit nr. 115, datë 03.11.2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, përcaktohet se: “Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë”.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e çështjeve që janë kompetencë e organeve si prokuroria e gjykata, bazuar në pretendime që lidhen me kundërvajtje apo vepra penale të parashikuara në legjislacionin penal të Republikës së Shqipërisë, apo për më tepër kontrolli i vendimmarrjeve të Prokurorisë, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së.

Në nenin 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) .....është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.”. Mungesa e kompetencës së Komisionerit për shqyrtimin e këtij pretendimi të paraqitur nga ankuesi, e bën ankesën të papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj<sup>2</sup>.

<sup>1</sup> Për analogji shih vendimet nr. 64, datë 27.04.2023 dhe nr. 167, datë 23.08.2023 të Komisionerit.

<sup>2</sup> Për analogji citojmë Vendimet nr. 54, datë 11.04.2023 dhe nr. 203, datë 19.10.2023, të KMD-së.

## **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b” dhe “dh” të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e ankesës nr. 218, datë 17.10.2023, të paraqitur nga Gj.N kundër Bashkisë Lezhë dhe S.K, Prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, pasi është paraqitur tej afateve ligjore dhe është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**